

Protokoll për parandalim dhe veprim në rast të dhunës

Hyrje (rreth protokollit / projektit)

Ky dokument u përgatit në periudhë 4-mujore nga një grup punues i përbërë nga 20 pjesëmarrës nga 10 shkolla të mesme në qytetin e Shkupit, si më poshtë: SHMQSH "Orce Nikollov"; SHMQSH "Marija Kiri Sklodovska"; SHMQSH "Zdravko Cvetkovski"; SHMQSH "Georgi Dimitrov"; SHMQSH "Nikolla Karev"; SHMEJQSH "Vasill Antevski Dren"; SHMQSH "Rade Jovçevski Korçagin"; SHMQSH "Cvetan Dimov"; SHMQSH "Koço Racin"; SHMQSH "Dimitar Vllahov".

Dokumenti paraqitet në suazat e projektit "JO!Dhunës", implementuar nga Shoqata e Liderëve për Edukim, Aktivizëm dhe Zhvillim, me mbështetje financiare nga Agjencia për Rini dhe Sport e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Projekti synon të rrisë sigurinë dhe të zvogëlojë dhunën në shkollat e mesme, përmes zhvillimit të protokollit të unifikuar për parandalim dhe veprimin në rast të dhunës.

Qëllimet

Ky dokument synon të edukojë dhe të krijojë mjedis të sigurt për të gjithë, në të cilin do të ndjehen të mirëpritur, të sigurt dhe të aftë të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore dhe të përmbushin potencialin e tyre duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë.

Për më tepër, qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë nevojën për veprim dhe reagim në rast të dhunës, të punojë në riintegrimin e viktimave dhe autorëve dhe të rrisë ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve në shkolla për dhunën dhe të përmirësojë sigurinë përmes promovimit të mjedisit të sigurt për të gjithë.

Kujt i dedikohet ky protokoll dhe kujt do t'i shërbejë?

Ky dokument u dedikohet për të gjithë palëve të interesuara në shkollë. Aty bëjnë pjesë nxënësit, prindërit / kujdestarët, këshilli i shkollës, drejtori, anëtarët e aktivës së ndryshme shkollore dhe profesionale, mësuesit, shërbimet profesionale dhe personelin tjetër që në një farë mënyre kanë rol aktiv në proceset e ndryshme në mjedisin shkollor. Ky dokument përfshin përmes bashkëpunimit të gjitha institucionet përkatëse që punojnë në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

Informim

Këtë dokument shkolla e publikon në ueb faqen e shkollës dhe vende të tjera të dukshme brenda shkollës në mënyrë që të jetë i publikisht i qasshëm dhe i dukshëm nga të gjithë palët e interesuara.

Për më tepër, shkolla merr përsipër obligimin të njëjtin ta ndërmarrë në mënyrë elektronike, dhe më pas me kopje fizike ta paraqesë te të punësuarit e saj (përfshirë të gjithë personat dhe pozitat) dhe zhvillon

minimum dy herë në vit prezantime / punëtori informuese mbi protokollin për punonjësit e saj.

Shkolla është e detyruar të paraqesë këtë protokoll të paktën dy herë në vit para nxënësve të të gjitha viteve shkollore përmes organizimit të prezantimeve / punëtorive informuese mbi protokollin. Për të genë më të informuar në lidhje me këtë protokoll në suazat e shkollës dhe mes nxënësve, një version i shkurtër prej 2 faqeve të këtij dokumenti do të vendoset në çdo klasë në shkollë.

Për më tepër, shkolla ka për detyrë të njoftojë bashkëpunëtorët e jashtëm dhe persona të tjerë që në një farë roli marrin pjesë në zhvillimet e ndryshme në shkollë për ekzistencën dhe zbatimin e këtij protokoll.

Nëse është e nevojshme, shkolla organizon aktivitete shtesë së bashku me nxënësit për të promovuar dhe informuar në lidhje me ekzistencën e këtij protokoll siç janë ligjërata, fushata, debate dhe të ngjashme.

Aktivitete të propozuara informuese dhe edukative që shkolla mund të zbatojë për të parandaluar dhe edukuar në lidhje me dhunën:

- Punëtori informuese / edukative dhe prezantime mbi dhunën;
- Punëtori informuese / edukative dhe prezantime mbi të drejtat e njeriut;
- Punëtori dhe prezantime informuese / edukative mbi përdorimin e sigurt të teknologjive dhe mjeteve të informimit dhe komunikimit, përfshirë sigurinë në internet;
- Punëtori informuese / edukative dhe prezantime mbi të drejtën e privatësisë dhe të dhënave personale;
- Organizimi i sesioneve për mbështetjen dhe inkurajimin e personave në rrezik, viktimat, autorët dhe dëshmitarët në rast të dhunës;
- Organizimi i aktiviteteve ndërklasore (gara, aktivitete shtesë, diskutime);
- Organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore në lidhje me sportin dhe bashkëpunimin.

*** Në rast se shkolla ka dyshim / njohuri për dhunë me persona të lidhur me një shkollë tjetër, me qëllim parandalimin dhe informimin, shërbimet profesionale kanë detyrimin të kontaktojnë shkollat të tjera dhe të adresojnë dyshimet / njohuritë e tyre.

Vlerat dhe parimet që respektohen dhe kultivohen nga ky protokoll

- Interesi më i mirë i fëmijës
- Respektimi i diversitetit dhe ndalimi i diskriminimit
- Respektimin e së drejtës për vetëvendosje
- Pjesëmarrje
- Privatësi
- Konfidencialiteti
- Viktima nuk është fajtores
- Proporcionalitet
- Informim

- Profesionalizëm dhe përgjegjësi
- Kujdesi i duhur
- Ndalimi i nepotizmit dhe korrupsionit

Llojet e dhunës dhe rolet

Cfarë është dhuna?

Ndërmarrja e një aktiviteti me të cilin qëllimisht / me plan i shkakton dëmtim një ose më shumë personave duke përdorur fjalë, duke treguar epërsi fizike, agresion verbal, izolim / tjetërsim social dhe / ose përdorim të kërcënimit në mënyrë që të shkaktojë dëm dhe të vendosë personin tjetër / personat tjetër në pozitë të nënshtruar.

Llojet e dhunës:

- Dhuna fizike
Dhuna fizike është aktivitet ku përdoret forca fizike (me ose pa mjete / sende shtesë) dhe drejtohet drejtpërdrejt në trupin fizik të personit në mënyrë që të shkaktojë dhimbje dhe të tregojë epërsi. E njëjta përfshin: goditje fizike, ngacmim dhe ndëshkim.
- Dhuna psikologjike, verbale dhe emocionale
Dhuna psikologjike, dhuna verbale dhe emocionale karakterizohen nga një sërë aktivitetesh me çka hyn në veprim ngacmimi psikologjik, përdorimi i komunikimit të dhunshëm verbal dhe abuzimit emocional në mënyrë që të shkaktohet dhimbje psikologjike dhe të tregohet fuqi. Kjo përfshin: përdorimin e fjalëve abuzive, mesazhe verbale, frikësim, kërcënim dhe shfrytëzim, etiketim, ofendim, kufizim të lëvizjes dhe shantazhe në mënyrë që ta vendoset personi në pozitë të nënvlerësuar.
- Dhuna sociale
Dhuna sociale paraqet akt të ndarjes së personit nga grupi, vendosja e tij në pozitë të pabarabartë mbi bazën e të ndryshmëve, injorim dhe refuzim.
- Dhuna nga moshatarët (bullying)
Dhuna e bashkëmoshatarëve është grup veprimesh dhe nxitjesh të qëllimshme të padëshiruara, që nxisin mjedis armiqësor në mënyrë që të dëmtojnë ose shkaktojnë shqetësime tek një person. Dhuna e bashkëmoshatarëve mund të shoqërohet me elemente të dhunës fizike, psikologjike, kibernetike, emocionale dhe lloje të tjera të dhunës.
- Dhuna nga urrejtja
Të gjitha llojet dhe format e dhunës mund të motivohen nga dhuna nga urrejtja ose paragjykimet që lidhen me karakteristikën e një personi, personat e lidhur me atë person, përkatësinë ose shkaqe të tjera.

- **Dhuna kibernetike**
Dhuna kibernetike është një formë e ngacmimit dhe veprimeve të drejtpërdrejta të dhunës përmes përdorimit të mjeteve dhe teknologjive të informimit dhe komunikimit si celularët, kompjuterët dhe interneti. Të gjitha veprimet si shpërndarja e fotove dhe videove, dërgimi i mesazheve (email, sms, çat), shkëmbimi i drejtpërdrejtë / indirekt dhe postimi i informacionit të ndjeshëm në lidhje me një person, krijimi i profileve të rreme dhe veprime të tjera pa miratimin paraprak të drejtpërdrejtë, nxitja dhe realizimi i dhunës përmes rrjeteve sociale, konsiderohen si elemente të dhunës kibernetike.
- **Dhuna seksuale**
Dhuna seksuale paraqet sjellje fizike, verbale ose simbolike e një natyre seksuale me të cilën një person ngacmohet seksualisht, fyhet ose detyrohet në sjellje me përmbajtje seksuale të cilat nuk i dëshiron, nuk i kupton, nuk mund ose nuk ka dhënë pëlqim. Dhuna seksuale përfshin: nxitje dhe detyrim për aktivitet seksual, abuzimin e një personi dhe krijimin e një hapësire të pasigurt, përdorimin dhe shpërndarjen e materialeve audio dhe vizive.
- **Dhuna me bazë gjinore**
Dhuna me bazë gjinore paraqet kombinim të formave të dhunës seksuale, fizike dhe / ose psikologjike si pasojë e normave gjinore dhe stereotipave të krijuara sociale dhe shpërndarjes së pabarabartë të pushtetit midis pozicioneve sociale të burrave dhe grave në shoqëri. Dhuna me bazë gjinore karakterizohet nga: dhuna e partnerit në marrëdhëniet intime, kontrolli dhe vendosja e ndalimeve, shantazhi dhe izolimi.
- **Dhuna sportive**
Dhuna sportive përfshin dhunën gjatë të gjitha aktiviteteve sportive brenda dhe jashtë lokacioneve të shkollës pa kufizuar përfshirjen e individit. Veprimet si përhapja e mesazheve që provokojnë dhe nxisin urrejtje ose dhunë bazuar në përkatësinë racore, kombëtare dhe fetare ose në bazë të karakteristikave të tjera; hedhja e objekteve në fushën e sportit ose në stadium; djegia dhe hedhja e mjeteve piroteknike; thirrja, nxitja dhe pjesëmarrja në rrahje ose sulm fizik ndaj sportistëve, rojeve të sigurisë, personave zyrtarë; konfrontim fizik midis pjesëmarrësve në gara sportive; spektatorë që hyjnë në fushën sportive; dëmtimi ose shkatërrimi i pajisjeve sportive dhe pjesëve të tjera të objektit ku zhvillohet ngjarja.
- **Dhuna në familje**
Dhuna në familje konsiderohet si sjellja e një anëtar të familjes që përdor forcën, kërcënimin ose frikësimin për të shkaktuar dëmtim trupor, keqpërdorim emocional ose seksual dhe shfrytëzim material, seksual ose të punës mbi një anëtar tjetër të familjes.
*** Në rast dyshimi / njohurie për dhunën në familje, e njëjta menjëherë adresohet te shërbimet profesionale për veprim të mëtejshëm në përputhje me rregulloret ligjore.

Rolet:

- /Viktima/t - Secili/të gjithë person/at për të cilët shkolla është në dijeni ose dyshon se kanë përjetuar ose po përjetojnë aktualisht dhunë;
- Dhunues/ë - Çdo/të gjithë person / persona për të cilët shkolla ka njohuri ose për të cilët ekzistojnë dyshime themelore se ai / ajo ka kryer dhunë;
- Dëshmitar/ët - Çdo person / persona që ka dëshmuar personalisht ose ka ndonjë njohuri se një person / grup tjetër ka përjetuar dhunë.

Veprimi

1. Ndërgjegjësimi për dhunën, njohja dhe raportimi i dhunës

Çdo person që është brenda ose jashtë shkollës dhe ka njohuri për dhunën ndaj njerëzve nga shkolla ka detyrimin ta raportojë atë tek personat e kontaktit për dhunë në shkollë(specifikoni personin / personat e kontaktit) ose te punonjësit e shkollës (mësues kujdestar, ndihmës drejtor, drejtor, shërbimi profesional, kujdestari i klasës, mësues, staf teknik, roje sigurie).

- Në **rast kur dyshimi ndahet me një punonjës** i njëjti ka detyrimin të kontaktojë personat për kontakt dhe së bashku të përcaktojë masat e mundshme mbrojtëse.
- Në **rast se dyshimi ndahet me bashkëmoshatar** (nxënës-nxënës) ose person tjetër i besuar, personi që ka njohuri ka detyrimin të kontaktojë punonjës ose të kontaktojë personat e kontaktit në shkollë.
- **Të gjithë punonjësit**, drejtori, shërbimet profesionale, mësuesit kanë obligim dhe janë të detyruar të vërejnë çdo ditë nëse ekziston rreziku për dhunë, nëse ndodh dhuna, nëse ndonjë nxënës është viktimë e dhunës apo nëse ndonjë nxënës sillet dhunshëm.
- Në rast se punonjësit vërejnë sjellje ose situata që tregojnë dhunë, ata kanë detyrimin të njoftojnë personat për kontakt/ shërbimet profesionale, kujdestarin e klasës ose një mësues tjetër i cili ka vendosur komunikim me nxënësit e prekur nga dhuna të cilët do të vazhdojnë të monitorojnë situatën ose do të punojnë për të vendosur masa mbrojtëse.
- Në **rastin kur nxënësi viktimë** raporton dhunë ndaj një punonjësi të shkollës, duhet të merret parasysh që personi i beson atij punonjësi dhe i njëjti duhet të vazhdojë të përfshihet në proces, gjatë krijimit të masave mbrojtëse dhe mban komunikim të rregullt me viktimën.

***** Me qëllim sigurimin e kanalit të sigurt për raportimin e dhunës ose dyshimit, shkollat krijojnë online kanal për raportimin e dhunës (formë) dhe vetëm personat e kontaktit / shërbimet profesionale kanë qasje në të dhënat. Kjo formë është në dispozicion në..... (të shtohet link ose shpjegim të shkurtuar ku mund të gjendet formulari)**

Personeli i shkollës, kanë kujdes në lidhje me shenjat e mundshme të dhunës që mund të paraqiten, fizikisht, fiziologjikisht, emocionalisht tek nxënësit, dhe në rast dyshimi ata kanë detyrimin ta ndajnë këtë me personat e kontaktit / shërbimet profesionale.

2. Ndalimi i dhunës

I gjithë personeli i shkollës që ka informacion ose ka parë vetë incidentin ka detyrim të ndalojë dhunën.

- Nxënësit kanë për detyrë të informojnë punonjësit dhe nuk rekomandohet që ata të ndalojnë dhunën në mënyrë që të mos e vënë veten në rrezik.
- Personat e kontaktit informohen për ngjarjen dhe sipas vlerësimit aktual, nëse bëhet fjalë për formë më serioze, thërritet **sigurimi**.
- **Sipas nevojës thërritet policia** si institucion përgjegjës për ruajtjen e sigurisë publike, rendit dhe paqes.

3. Sigurimi i një ambienti të sigurt dhe qetësimi i situatës

Pasi dhuna është ndaluar, të punësuarit ndërmarrin masat e duhura për të qetësuar situatën.

- Punonjësi që ndaloi dhunën informon dhe përfshin personin e kontaktit për raportimin e dhunës.
- Personi i kontaktit vlerëson në varësi të rrethanave të rastit, nëse do të përfshijë mësues të caktuar, bashkëpunëtorë profesionistë, drejtorë, prindër, përfaqësues të institucioneve të tjera përkatëse siç janë: institucionet shëndetësore dhe institucione të këshillimit, policinë, qendrën për punë sociale dhe të tjerët.
- Për të siguruar mjedis të sigurt dhe për të qetësuar situatën, është e nevojshme të merren informacione për shkaqet dhe faktorët që çuan në dhunë, të përcaktohet se kush ishte përfshirë në dhunë, sa kohë zgjati, nëse është përsëritur dhe informacione të tjera përkatëse të cilat në pajtim me vlerësimin e personave profesionalë, janë të nevojshme. Këto biseda (intervista) kryhen nga personat e kontaktit / shërbimet profesionale.
- Bisedohet me të gjithë nxënësit e përfshirë në dhunë, nxënësin viktimë, nxënësin dhunues dhe nxënësit vëzhgues, dhe nëse është e nevojshme, me nxënësit që mund të jenë ndërmjetësues (nëse ka). Bisedat me nxënësit zhvillohen veçmas dhe bisedat vazhdojnë për aq kohë sa ka nevojë sipas vlerësimit të ekspertëve.

*** Gjatë konsultimeve dhe të gjithë procesit në shkollë ose jashtë saj, respektohet parimi i konfidencialitetit, si dhe parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.

*** Një koncept i rëndësishëm duhet të merret parasysh gjatë sigurimit të mjedisit të sigurt që të mos ketë viktimizim të dyfishtë të viktimës.

4. Evidentimi, edukimi, transformimi dhe monitorimi

Në mënyrë që të monitorohet siç duhet rasti dhe të transformohet, i njëjti:

- evidentohet dhe
- shndërrohet.

Shërbimet profesionale në shkolla punojnë në edukimin me të gjitha palët e përfshira në rastin dhe, nëse është e nevojshme, të gjithë palët e interesuara që drejtpërdrejt nuk kanë marrë pjesë në këtë rast. Në varësi të kompleksitetit të situatës, konsultat mund të kryhen me shërbime jashtë shkollës: QPS, Institucione shëndetësor, MPB dhe të tjerët.

*** Sipas vlerësimit të personit të kontaktit / shërbimeve profesionale, zhvillohet plan për edukim dhe transformim i cili synon të punojë në edukimin dhe transformim me autorin/ët e veprës dhe të sigurojë mbrojtje dhe mbështetje për viktimën (at) me qëllim të **riintegrit**. Kjo paraqet mundësi për krijimin e mjedis të sigurt për të gjithë ku çdo individ mund të jetë me shëndet të mirë dhe të përmbushë potencialin e tij në mënyrë që të arrihet jetë cilësore dhe të jetojë në mirëqenie.

Formularët për adresimin e dhunës, evidentim dhe vlerësimin e veprimit në lidhje me rastin

Adresimi

Adresimi (raportimi) i dhunës në shkollë mund të bëhet me raportim te punonjësit / personat përgjegjës / personat të kontaktit / shërbimet profesionale në shkollë, përmes kutisë postare anonime të vendosur brenda ndërtesës së shkollës ose në internet përmes formës anonime të disponueshme në lidhjen/linkun vijues - - ----- (shto lidhjen/linkun). Me qëllim adresimin dhe veprimin përkatës, personat që raportojnë një ngjarje janë të detyruar të japin informacion të saktë dhe të vërtetë në mënyrë që autoritetet të kenë informacionin minimal të nevojshëm dhe të jenë në gjendje të kontrollojnë dhe verifikojnë ngjarjen.

Shkolla krijon formën e mëposhtme të adresimit të dhunës:

- Të dhëna për personin që raporton (nëse dëshiron të ndajë identitetin e vet)

Informacionet e nevojshme: Emri dhe mbiemri, roli (nxënës / punonjës / tjetër), fusha për kontakt informacione

(rrethoni / zgjidhni nëse bëhet fjalë për formular për dyshim apo një ngjarje që ka ndodhur tashmë)

1. **Formulari për ngjarjen** - Formulari duhet të përmbajë përshkrim të shkurtër të incidentit dhe personave të përfshirë.

Informacionet e nevojshme: vendi i ngjarjes, ora dhe data e ngjarjes (periudha kur ka ndodhur), pjesëmarrësit në ngjarje (autorët dhe viktimat), dëshmitarë / të pranishëm të tjerë, përshkrimi i shkurtër i ngjarjes, arsyeja e ngjarjes (nëse dihet).

2. **Formulari për dyshim për ngjarje** - Formulari duhet të përbëhet nga një përshkrim i shkurtër në lidhje me dyshimin.

Informacionet e nevojshme: përshkrim i shkurtër i dyshimit, personat e përfshirë, ku ata persona / nxënës bëjnë pjesë (në cilën shkollë, klasë), vendi dhe koha e ngjarjes së mundshme, mbi të cilën bazohet dyshimi.

*** Në fund të formularit shënohet mesazh në mënyrë që të inkurajohen personat që raportojnë nëse dëshirojnë të drejtohen te shërbimet përgjegjësie për trajtimin e dhunës në mënyrë të drejtpërdrejt.

Evidentimi

Shkolla ka detyrimin të mbajë shënime të sakta dhe të rregullta në lidhje me raportime ose ngjarje të dyshimta. Në formularin për evidentim shkolla evidenton këto informacione:

Vendi dhe koha, lloji i dhunës, kush e zbuloi / raportoi rastin, sa pjesëmarrës janë të përfshirë (të dhëna për pjesëmarrësit), nëse personat e përfshirë janë nga vetë shkolla apo ka persona jashtë shkollës të përfshirë, nevoja të përfshihen institucione të jashtme (MPB-ja, QPS-ja, institucionet shëndetësore, etj.), nëse ndodh për herë të parë apo krimi përsëritet dhe informacione të tjera shtesë. Shkollat kanë detyrimin të mbajnë plan pune me të gjithë personat e përfshirë në incident, llojet e ndërhyrjeve të ndërmarra, masat e propozuara për mbrojtjen e viktimës, mënyrat e monitorimit të masave / ndërhyrjeve të zbatuara dhe informacione të tjera përkatëse.

Vlerësimi / evaluim

Me qëllim vlerësimin dhe evaluimin përkatës të efikasitetit të punës së shkollës në mënyrë që të zbatohet ky protokoll, parandalim dhe veprim në rast të dhunës, shkolla bën vlerësimin e punës së saj. Ajo zbatohet në dy fusha:

1. Vlerësimi i efektivitetit të planeve të ndërmarra dhe masave të zbatuara për punë në rast të veprimit për dyshim / ngjarje dhune përmes një forme që përmban pyetjet e mëposhtme:
 - Nëse dhuna është ndaluar?
 - Nëse dhuna është qetësuar?
 - Cila është gjendja e viktimës / viktimave?
 - Cila është gjendja e dhunuesit/ ve?
 - Si është gjendja e mjedisit?
 - Nëse dhe çfarë intervenime plotësuese janë të nevojshme?
2. Vlerësimi i efikasitetit në drejtim të parandalimit të dhunës
Kjo formë përbëhet nga pyetje për vlerësimin e informimit për ekzistencën e këtij protokollit dhe zbatimin e tij në shkollë përmes pyetjeve të mëposhtme:
 - A jeni në dijeni të ekzistencës së protokollit për parandalim dhe veprim në rast të dhunës në shkollë?;
 - A keni marrë pjesë në prezantim / punëtori mbi protokollin për parandalim dhe veprim në rast të dhunës në shkollë?;
 - Nëse organizohen aktivitete shtesë në lidhje me parandalimin dhe veprimin në rast të dhunës në shkollë, a do të merrni pjesë?;
 - Çfarë mund të bëjë shkolla më shumë për të informuar nxënësit në lidhje me protokollin?;
 - A keni qenë ndonjëherë i përfshirë në ndonjë ngjarje të dhunshme?;
 - Nëse po, a ka vepruar shkolla në këtë rast?;
 - Nëse po, çfarë ka bërë shkolla?;
 - Nëse nuk do të vepronte, çfarë mund të bënte?;
 - Komente të tjera.

Protokoll për parandalim dhe veprim në rast të dhunës

VERSION I SHKURTUAR

Të dashur nxënës,

Në mënyrë që të ndjeheni të mirëpritur dhe të sigurt në shkollë, duam t'ju informojmë se në shkollën tonë kemi **Protokoll për parandalim dhe veprim në rast të dhunës**. Ky dokument synon të edukojë dhe të krijojë mjedis të sigurt për të gjithë, në të cilin do të ndjehen të mirëpritur, të sigurt dhe të aftë të gëzojnë të drejtat e tyre njerëzore dhe të përmbushin potencialin e tyre duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë. Për më tepër, ky protokoll përcakton veprimin dhe reagimin në rast të dhunës dhe ai do të na shërbejë në edukimin, veprimin dhe riintegrimin e të gjithë palëve të prekura nga dhuna në shkollë përmes zbatimit të aktiviteteve të ndryshme gjatë vitit shkollor.

Të informohemi dhe edukohemi

Cfarë është dhuna?

Ndërmarrja e një aktiviteti me të cilin qëllimisht / me plan i shkakton dëmtim një ose më shumë personave duke përdorur fjalë, duke treguar epërsi fizike, agresion verbal, izolim / tjetërsim social dhe / ose përdorim të kërcënimit në mënyrë që të shkaktojë dëm dhe të vendosë personin tjetër / personat tjetër në pozitë të nënshtruar.

Llojet e dhunës:

- Dhuna fizike
- Dhuna psikologjike, verbale dhe emocionale
- Dhuna sociale
- Dhuna nga moshatarët (bullying)
- Dhuna nga urretjtja
- Dhuna kibernetike
- Dhuna seksuale
- Dhuna me bazë gjinore
- Dhuna sportive

Në rast të dhunës, të gjithë kemi një rol për të luajtur dhe mund ta identifikojmë

- /Viktima/t - Secili/të gjithë person/at për të cilët shkolla është në dijeni ose dyshon se kanë përjetuar ose po përjetojnë aktualisht dhunë;
- Dhunues/ë - Çdo/të gjithë person / persona për të cilët shkolla ka njohuri ose për të cilët ekzistojnë dyshime themelore se ai / ajo ka kryer dhunë;
- Dëshmitar/ët - Çdo person / persona që ka dëshmuar personalisht ose ka ndonjë njohuri se një person / grup tjetër ka përjetuar dhunë.

Siguria e të gjithëve është në vend të parë

Kur kemi njohuri për dhunë dhe / ose identifikojmë dhunë, kemi detyrimin ta adresojmë / raportojmë

ngjarjen → Çdo person që është brenda ose jashtë shkollës dhe ka njohuri për dhunë ndaj personave nga shkolla ka detyrimin ta raportojë atë tek personat e kontaktit për dhunë në shkollë.....**(specifikoni personin /**

personat e kontaktit) ose te të punësuarit e shkollës (arsimtar kujdestar, ndihmës drejtor, drejtor, shërbim profesional, kujdestar klase, mësues, staf teknik, roje sigurie).

Ndihuni të qetë tu qaseni shërbimeve profesionale për bisedë. nëse nuk ndiheni të sigurt, ata janë në shërbimin tuaj dhe janë këtu për ju.

Si duhet të reagoj në rast të dhunës?

- Në rast se jeni i pranishëm në vendin ku ndodh dhuna, keni detyrim të informoni menjëherë personin e kontaktit ose stafin e shkollës në mënyrë që dhuna të ndalet.

*** Është e rëndësishme të mos e vendosni veten në rrezik. Të rriturit në shkollë janë "ndihma e parë" për ju, në rast të dhunës.

- Nëse keni dyshim / informacion se ndodh dhunë, keni detyrim ta adresoni te personat e kontaktit ose punonjësit e shkollës për veprim përkatës, me qëllim krijimin e mjedisit të sigurt për të gjithë.
- Nëse ndonjë nga shokët tuaj të klasës ndan informacione me ju në lidhje me dhunën, në mënyrë që të reagoni në mënyrë të përshtatshme dhe të krijoni mjedis të sigurt, njoftoni personat e kontaktit / shërbimet profesionale.

*** Nëse dëshironi të qëndroni anonim ose nuk ndiheni të sigurt të raportoni drejtpërdrejt dyshimin / ngjarjen / informacionin në lidhje me dhunën, mund ta bëni këtë online duke plotësuar formular në lidhjen/linkun e mëposhtëm ([vendosni lidhjen/linkun](#)).

Është e rëndësishme të dihet

- Të gjithë duhet të dimë se çfarë është dhuna dhe të jemi të vetëdijshëm për veprimet tona, cilat role kemi, çfarë bëjmë dhe si ndikon kjo tek njerëzit përreth nesh.
- Të gjithë kemi detyrim të raportojmë dyshim / informacion / ngjarje në lidhje me dhunën në dhe jashtë shkollës në mënyrë që të mbrojmë veten dhe bashkëmoshatarët tanë, te personat e kontaktit, punonjësit ose përmes online formularit në dispozicion në lidhjen/linkun e mëposhtëm ([vendosni lidhjen/linkun](#)).
- Siguria është prioritet për të gjithë. Të rriturit në shkollë janë "ndihma e parë" për ju, në rast të dhunës.
- Shërbimet profesionale në shkollë (pedagog / psikolog) janë këtu për ju dhe punojnë në interesin më të mirë të sigurisë së të gjithëve.

*** Respektimi dhe zbatimi i këtij protokoll është thelbësor për krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë, në të cilin çdo person do të mirëpritet dhe do të ndihet i sigurt. Versioni i plotë i këtij protokoll është i disponueshëm në ueb faqen e shkollës, është vendosur në ([vendndodhja në shkollë](#)). Për çdo pyetje në lidhje me këtë protokoll mund të kontaktoni shërbimet profesionale në çdo kohë.

Lista e anëtarëve të grupit të punës

Ky dokument u përgatit nga një grup pune i përbërë nga:

Angelina Stevkovska Maksimovska - pedagog shkollor në SHMQSH "Orce Nikollov"

Sasha Tofoska - nxënës në SHMQSH "Orce Nikollov"

Svetlana Asprovskaja - Todoroviç - psikologe shkollore në SHMQSH "Georgi Dimitrov"

Milena Kačaniklievska - nxënës në SHMQSH "Georgi Dimitrov"
Gordana Blazhevska Spiridonova - psikologe shkollore në SHMQSH "Nikolla Karev"
Kristijan Popovski - nxënës në SHMQSHS "Nikolla Karev"
Indxhi Hajredin - arimstar i lëndës në SHMQSH "Zdravko Cvetkovski"
Ilija Naumovski - nxënës në SHMQSH "Zdravko Cvetkovski"
Mirjana Krstevska - arsimtar i lëndës në SHMQSHGS "Dimitar Vlahov"
Viktorija Kocevska - nxënës në SHMQSH "Dimitar Vlahov"
Jelena Arsovska - mësuese e lëndës në SHMQSH "Rade Jovcevski Korçagin"
Andrej Ristiç - nxënës në SHMQSH "Rade Jovcevski Korçagin"
Jasmina Bedriosa - mësuese e lëndës në SHMQSH "Marija Kiri Sklodovska"
Konstantin Veliçkovski - nxënës në SHMQSH "Marija Kiri Sklodovska"
Darko Kostovski - mësues i lëndës në SHMQSH "Koço Racin"
Simon Nikollovski - nxënës në SHMQSH "Koço Racin"
Tina Gocevska Angelovska - mësuese e lëndës në SHMEJQSH "Vasill Antevski Dren"
Tamara Kunculova - nxënëse në SHMEJQSH "Vasill Antevski Dren"
Ajla Bilali - mësuese e lëndës në SHMQSH "Cvetan Dimov"
Hanife Jakupi - nxënëse në SHMQSH "Cvetan Dimov"